

STATUTI

2 S R L ' GROUP

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 14.09.2020 (14 Shtator 2020), ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **2 S R L ' GROUP SH.P.K.**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- Z. SEBASTJAN SKËNDERI, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20.07.1991, lindur në Lushnje, dhe banues në adresën: Rruga Komuna Parisit P.6 Ap.1, TIRANE, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit te identitetit tip karte me Nr. Personal J10720128I, i leshuar nga MB në datën 06.02.2020.
- Z. REMIR LLAKAJ, shtetas shqiptar, i datëlindjes 26.11.1988, lindur në Kavaje, dhe banues në adresën: Rruga Frederik Shiroka P.2 Ap.3, TIRANE, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit te identitetit tip karte me Nr. Personal I81126056E, i leshuar nga MB në datën 29.08.2019



Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- Import-Eksport të artikujve të ndryshëm, tregti me pakicë dhe shumicë të artikujve dhe mallrave të ndryshëm, produkteve ushqimore, kafese dhe pijeve të ndryshme.

Faqja 1 nga 12



- Hoteleri, restorante, bare, sherbime catering dhe delivery si dhe gjithçka të lidhur me këtë fushë me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për ecurin e biznesit.
- Sherbime marketing, promocijoni, organizim eventesh etj. Qender prenotimi dhe sherbimesh turistike, turizëm. Aktivitete dhe analiza statistikore dhe konsultime te pergjithshme brenda dhe jashtë Shqiperise.
- Shoqëria ka për objekt import-eksportin, prodhimin, industrializimin dhe tregtimin e të gjitha produkteve drusore, elektrike, hidraulike, kancelarike si dhe cdo produkt tjeter të deshiruara që nuk bien ndesh me asnjë Ligj, qoftë drejtpërdrejt ose përmes palëve të treta, kryesisht mallra e produkte të nevojshme për kryerjen aktivitetit ekonomik e përbushjen e objektivave tregtare.
- Si pjesë e aktivitetit të saj shoqëria mund të kryej sherbime ne fushen e lavanderise, tregtimin e matrialeve pastrues si detergjent dhe produkteve te ngjashem me to.
- Shoqeria ka per objekt import-eksport si dhe tregtim me shumice dhe pakice te produkteve parafarmaceutike.
- Shoqeria mund te kryej sherbime informatike, mirmajtje rrejti, shitje me shumice dhe pakice te pajisjeve komjuterike si dhe pjeseve perberese te saj.
- Shoqeria mund te ofroje sherbime honorare, konsulenca ligjore, financiare, projekte, perkthime etj.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

Kohëzgjatja e Shoqërisë 2 S R L ' GROUP SH.P.K. vendoset për një periudhë të pacaktuar kohore nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Rr. Abdyl Frasherit, Shkalla 1, Kati 4, Ap 3, Pallati Hekla, ZK 8270 TIRANË.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

2srl2020@gmail.com

+355 69 35 76 713

Kreu II

KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITAL THEMELTAR,

Faqja 2 nga 12

SHPËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme. Kontributi i kapitalit themeltar ka ndodhur si vijon:

1.Ortaku Themelues: Z. SEBASTJAN SKËNDERI : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 Leke (Pesëdhjetë mijë) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Ortaku i ka depozituar kapitalin themeltar prej 50,000 (Pesëdhjetë mijë) lekë në një llogari bankare.

2.Ortaku Themelues: Z. REMIR LLAKAJ : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 Leke (Pesëdhjetë mijë) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Ortaku i ka depozituar kapitalin themeltar prej 50,000 (Pesëdhjetë mijë) lekë në një llogari bankare.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e ortakëve e një eksperti kontabël të regjistruar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.


Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat mund t'iu transferohen palëve të treta tërësisht ose pjesërisht nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin themeltar;

Faqja 3 nga 12



- b) Blerjes - shitjes së kuotave;
- c) Trashgimisë;
- d) Dhurimit;
- d) Çfarëdo mjeti tjeter të parashikuar nga ligji.

Në rastin e transferimit të ndonjë titulli te kuotave ndaj palëve të treta, ortakët e tjerë mund të preferohen në blerjen e kuotave në proporcione me kuotat e tyre në të njëjtin çmim dhe nën kushte të njëta të ofruara nga pala e tretë.

Në këtë rast ortaku shitës duhet t'iu komunikojë ortakëve të tjerë çmimin e ofruar nga pala e tretë, duke siguruar prova me shkrim të ofertës, dhe ortakët e tjerë do të kenë 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës për të informuar ortakun shitës dhe ortakët e tjerë per vullnetin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Kur ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit kohor, do të thotë se kanë hequr dore nga e drejta e parablerjes në favor të tyre.

Nëse një prej ortakëve të tjerë, që ofrohet për të blerë ne parablerje për pjesen e tij kuotat e ortakut të shitjes, nuk synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, ortakët e tjerë të cilët kanë ushtruar tashmë per pjesën e tyre të drejtën e tyre të parablerjes mund të zgjerojnë këtë të drejtë për të gjitha ose një pjesë të kuotave të ofruara në parablerje për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.

Në rast se më shumë ortakë dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e parablerjes, të ofruara për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes në mosmarrëveshje do të ndahet në pjesë të barabarta.

Në rastin kur vetëm njëri ortak dëshiron të zgjerojë të drejtën e tij te parablerjes, parablerjes në mosmarrëveshje ofruar për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, do të transferohet plotësisht në të gjitha ose pjesën qe ai synon për të blerë.

Në këtë aspekt, anëtarët dëshirojnë të zgjerojnë të drejtën e tyre të parablerjes duhet të njoftojë ortakun shites, vendimin e tij brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e njoftimit të mungesës për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

Të gjitha këto komunikime duhet të jenë me shkrim.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Faqja 4 nga 12

Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat epermendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh)mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shperndarjen e fitimeve vjetore
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.


Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Vendimet e shumicës të Asamblese janë detyruese per ortakë qe mungojnë ose jane kundër, por kane te drejten e ankimit në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Faqja 5 nga 12



Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande qe duhet t'u dergohet ortakëve – ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakëve ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpëra datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve



- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a)vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b)shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c)ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç)dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

- SKËNDERI, SEBASTJAN

Ruga Komuna e Parisit P.6 Ap.1, Tirane

-LLAKAJ,REMIR

Ruga Frederik Shiroka,Tirane

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.



Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkova. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;



- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTEL KONTABEL

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët Kontabël

Nëse është e nevojshme apo të kërkohet nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave te shoqerisë do t'i besohet një audituesi të autorizuar të emëruar në mënyrën e përcaktuar me ligj me te drejtë riemërimi.

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i regjistruar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakëve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Faqja 10 nga 12

Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se njejtë te emerimit.

Neni 18

Fitimet

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, zbritur 5% (pesë perqind) qe caktohen per rezerven ligjore deri ne 10% (dhjete per qind) te kapitalit themeltar, dhe gjithashtu te gjitha shumat e tjera qe Asambleja vendos t'i vere menjane, u shperndahen ortakëve ne proporcione pjeset e kapitalit themeltar te zotera respektivisht.

Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo edhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

Kreu V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 19

Prishja dhe Likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortakët merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Faqja 11 nga 12

Neni 20

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare."

Neni 21

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

U lexua, u nenshkrua dhe u firmos.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
2 S R L' GROUP

SEBASTJAN SKËNDERI



REMIR LLAKAJ

